



ALBSIG *Jete*



# RAPORTI VJETOR

## KONTAKT

**2019**



Rr. "Barrikadave", Albsig HQ, Kati  
8, Tiranë - Shqipëri



+355 (0) 254770



info@albsig-jete.al



www.albsig-jete.al

# PËRMBAJTJA

- Misioni dhe Vizioni.
- Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm
- Historiku i shoqërisë Albsig Jetë.sh.a
- Pronësia dhe Organet Drejtuese të Albsig-Jetë sh.a.
- Auditi i Jashtëm.
- Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2019.
- Struktura Organizative.
- Objektivat e shoqërisë Albsig-Jetë sh.a. për vitin 2020.

## MISIONI

*Albsig - Jetë është shoqëri sigurimi jete e orientuar nga cilësia, rritja e gamës së produkteve dhe portofolit, ruajtja e një gjendje financiare të shëndoshë, dhe e dedikuar të përmbushë sa më mirë kërkesat e konsumatoreve për produkte të sigurimit të jetës në tregjet dhe segmentet ku operon.*



## VIZIONI

*Vizioni i aksionerit të shoqërisë është pozicionimi i shoqërisë si një nga shoqëritë kryesore të sigurimit të jetës në vend, e cila ofron një gamë të gjerë produktesh tradicionale dhe novatore të sigurimeve të jetës.*

# MESAZH NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM ALBSIG-JETË.SH.A

**Ervin SPAHIU**

## ***Klientë të dashur!***

*Kam kënaqësinë të ndaj me ju Raportin Vjetor dhe ngjarjet më të rëndësishme të shoqërisë Albsig- Jetë sh.a. për vitin 2019*

*Për Shoqërinë Albsig -Jetë.sh.a viti 2019, ishte nje vit pozitiv pasi startoi jo vetëm me marrjen e licensës por dhe me fillimin e aktivitetit të shoqërisë.*

*ALBSIG-JETË Sh.a është një shoqëri aksionere e themeluar në vitin 2019, me aksioner të vetëm ALBSIG Sha, një nga kompanitë me trendin më të lartë të rritjes në tregun e sigurimeve gjatë viteve të fundit, si dhe pjesë e Grupit KASTRATI, një ndër sipërmarrjet më të rëndësishme dhe të suksesshme në tregun shqiptar.*

*ALBSIG-JETË Sh.a ka në fokus orientimin ndaj klientit, dedikuar rritjes së ndërgjegjësimit të tyre për të ardhmen dhe ofrimin e paketave të sigurimeve të jetës, duke plotësuarçdo kërkesë të mundshme të tyre me qëllim krijimin e një marrëdhënie të shëndetshme dhe afagjate.*

*ALBSIG -JETË do të jetë një nga kompanitë me inovatore në treg, ku paralelisht produkteve*

*tradicionale, target të rëndësishëm do të kenë edhe produkte të reja, duke u mundësuar klientëve dhe bashkëpunëtorëve tanë përfitime të qëndrueshme dhe të mëdha.*

*Besimi dhe siguria e klienteve tanë, si individë dhe kompani, krijuar në vite aplikimi i strategjive të mirëmenduara, ekspertiza e një stafi profesional dhe konsolidimi i marrëdhënieve me klientët, nxit synimin tonë drejt një pozicioni lider në tregun e sigurimeve të jetës.*

# HISTORIKU I ALBSIG JETË SH.A

Shoqëria e Sigurimeve Albsig-Jetë sh.a është themeluar me 2 Korrik 2019, duke u rënditur si shoqëria e katër në treg për sigurimin e jetës. Shoqëria operon në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe kuadrin rregullator, është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L92019017V në mbështetje të Vendimit Të bordit të AMF-së nr 171, datë 13.09.2019 për të ushtruar veprimtari sigurimi jete në territorin e Republikës së Shqipërisë ,në mbështetje të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Shoqëria Albsig-Jetë.sh.a është me aksioner të vetëm ALBSIG Sha, një nga kompanite me trendin me te larte te rritjes ne tregun e sigurimeve gjate viteve te fundit, si dhe pjese e Grupit KASTRATI, nje nder siper marrjet me te rëndesishme dhe te suksesshme ne tregun shqiptar.

Albsig-Jetë, ushtron aktivitetin e saj sigures, në përshtatshmeri dhe perputhje me kriteret e legjislacionit Shqiptar per Sigurimet dhe Risigurimet, në mbështetje të Vendimit Të bordit të AMF-së nr 171, datë 2. Korrik 2019 për të ushtruar veprimtari sigurimi jete në territorin e Republikës së Shqipërisë ,në mbështetje të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

E paisur me NIPT L92019017V, Albsig Jete ka te drejten te ushtroje veprimtarine e saj siguruese ne te tera klasat e Sigurimit te Jetes qe njeh ligji Shqiptar i sigurimeve.

Gjate periudhes se vitit 2019, Impenjimi kryesor ka qene ngritja e menjehereshme e strukturave efikase dhe operative per funksionimin operacional të shoqërisë .

Stafi i shoqërisë përbëhet nga individë me eksperiencë të suksesshme shumëvjeçare në tregun e sigurimeve.

Albsig Invest Sh.a. ka si aksioner të vetëm Albsig Jetë Sh.a.

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, është një shoqëri aksionare, me seli në Rrugën e Barrikadave, Albsig HQ, Kati 8, Tiranë. Albsig Invest Sh.a është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 04.10.2019. Albsig Invest Sh.a është licensuar Shoqëria Administruese me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) nr. 210, datë 22.11.2019 “Për të vepruar si shoqëri administruese e fondeve të pensionit vullnetar në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit, si dhe për administrimin e aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive” (Licensa nr. 5, datë 22.11.2019 pa afat). Me vendimin e mësipërm AMF miratoi edhe Fondin e Pensionit Vullnetar Albsig. Me vendimin e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), nr. 255, datë 30.12.2019, u miratua Fondi i Investimit Albsig Standard. Albsig Invest Sh.a mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij

## STRUKTURA E AKSIONERËVE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE



Aksioneri i vetëm i shoqërisë është Albsig Jetë Sh.a, i cili zotëron 100% të aksioneve. Shoqëria Administruese mund të ketë nën administrim një ose disa fonde pensioni dhe një ose disa fonde investimi ne të njëjtën kohë. Aktualisht Albsig Invest Sh.a ka nën administrim Fondin e Pensionit Vullnetar Albsig dhe Fondin e Investimit Albsig Standard.



## 19. Sigurimi i jetës:

- 19.1 sigurimin për vdekjen;
- 19.2 sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar;
- 19.3 sigurimin për mbijetesë deri në një moshë të caktuar ose për vdekje të parakohshme;
- 19.4 sigurimin e jetës me kthim të primeve

## 20. Sigurimi martesë - lindje :

- 20.1 shpenzimet që shoqërojnë martesën ose lindjen e fëmijëve;
- 20.2 përfundimi i kushteve të sigurimit, i cili ka lidhje me arritjen e një moshe të caktuar të fëmijës.

## 21. Sigurimi i jetës i lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive mbulon:

- 21.1 sigurimin e jetës, në rastet kur pagesa e sigurimit lidhet në mënyrë të plotë apo të pjesshme me vlerën e aksioneve apo kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, ose me vlerën e aktiveve të mbajtura në një fond të brendshëm nga siguruesi.

## 22. Anuitetet:

- 22.1 sigurim jete me elemente kursimi;
- 22.2 sigurim jete me afat të përcaktuar;
- 22.3 anuitete të shtyra;
- 22.4 anuitete të menjëhershme.

## 23. Sigurimi shtesë, i cili lidhet me kontratën e sigurimit të jetës, duke përfshirë një ose më shumë nga kombinimet e mëposhtme:

- a) vdekje si rezultat i aksidentit;
- b) paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti;
- c) paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një sëmundjeje;
- ç) paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti;
- d) paaftësi e përkohshme si rezultat i një sëmundjeje;
- dh) paaftësi për të kryer profesionin apo punën si rrjedhojë e dëmtimeve trupore;
- e) shërbimet spitalore;
- ë) sëmundjet e pashërueshme;
- f) shërbimet mjekësore.

# PRONËSIA DHE ORGANET DREJTUESE TE ALBSIG-JETË SH.A.

## INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Albsig Jetë sh.a. ("Shoqëria") është themeluar më 2 korrik 2019 si një shoqëri sigurimi me seli në Tiranë në adresën Rruga e Barrikadave, (Pallatet 9 Katëshe) Nr.1001. Shoqëria është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas ligjit nr.7638, datë 19 nëntor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 19 korrik 2019 me numer identifikimi L92019017V.

Shoqëria operon sipas liçensës nr.13 të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare ("AMF"), për tregtimin të ushtruar veprimtari sigurimi jete sipas rregullave të AMF-së në territorin e Republikës së Shqipërisë. Autorizimi për të ndërmarrë aktivitetet e sigurimit të jetës është marrë më datë 13 shtator 2019. Aktivitetet kryesore të biznesit përfshijnë dhënien e shërbimeve të sigurimit për sigurim jetë-vdekje, sigurim martesë-lindje, sigurim jete i lidhur me fondet e investimit, sigurim i administrimit të fondeve kolektive, sigurim shtesë.

Kapitali i Shoqërisë është 402,000 mijë Lek i ndarë në 402,000 aksione me vlerë nominale 1,000 Lke/aksion e zotëruar 100% nga Albsig Sh.a.

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria ka patur mesatarisht 4 punonjës dhe drejtues.

Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë

gjatë vitit 2019 deri në nënshkrimin e këtyre pasqyrave financiare janë:

- Plarent Hamzaj - Kryetar
- Redi Ujkashi-Anëtar
- Klodian Gjonaj - Anëtar





## RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe aksionarët e Shoqërisë Albsig Jetë sh.a

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **Albsig Jetë sh.a** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

### Theksim çështje

Ne tërheqim vëmendjen për shënimin 26 të pasqyrave financiare, i cili përshkruan vlerësimin e menaxhimit në lidhje me ndikimin aktual dhe potencial të pandemisë së COVID - 19 dhe për arsyen e aplikimit të parimit të vijueshmërisë për përgatitjen e pasqyrave financiare. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

### Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijueshmërisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

**Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomalitë materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomalitë materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticismin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësim të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënime shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

**Teit Gjini**  
Auditues Ligjor



29 maj 2020



# AUDITI I JASHTËM

Albsig Jetë sh.a

*(Vlerat janë në Lek)*

## PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR më 31 dhjetor 2019

	Shënime	<u>31 dhjetor 2019</u>
<b>AKTIVE</b>		
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	11	11,384,558
Depozita me afat me bankat	6	372,256,710
Llogari të arkëtueshme sigurimi, neto	8	2,077,607
Aktive të risigurimit	7	290,966
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	10	9,373,174
Inventari	9	10,000
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	13	372,270
Aktive afatgjata material	4	271,583
Aktive afatgjata jomateriale	5	120,120
Aksione në shoqëri të lidhura	12	32,000,000
<b>Totali i aktiveve</b>		<b><u>428,156,988</u></b>
<b>DETYRIMET</b>		
Rezervat për primet e pafitur	14	1,660,722
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15	19,254,940
Detyrim tatim fitimi	23	535,524
Detyrime të tjera	16	1,681,164
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b><u>23,132,350</u></b>
<b>KAPITALI</b>		
Kapitali aksionar	17	402,000,000
Fitimi i ushtrimit	23	3,024,638
<b>Totali i kapitalit</b>		<b><u>405,024,638</u></b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b><u>428,156,988</u></b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# AUDITI I JASHTËM

Albsig Jetë sh.a

(Vlerat janë në Lek)

## PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019
Prime të shkruara bruto	18	7,064,844
Prime të çeduar në risigurim		-
<b>Prime të shkruara neto</b>		<b>7,064,844</b>
Ndryshimi në rezervën e primeve të pafituara	14	(1,660,722)
Ndryshimi në shpenzime të shtyra	13	372,270
Ndryshimi në rezervën e primit të risiguresit	7	290,966
<b>Të ardhura neto nga primet e sigurimit</b>		<b>6,067,358</b>
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet		-
Të ardhura nga interesit	19	1,582,312
Të ardhura të tjera		-
<b>Të ardhura të tjera</b>		<b>1,582,312</b>
<b>Të ardhurat neto</b>		<b>7,649,670</b>
Kostot e marrjes në sigurim	20	(1,619,425)
Shpenzimet administrative	21	(3,140,966)
Shpenzime financiare neto	22	670,883
<b>Total shpenzime operative</b>		<b>(4,089,508)</b>
<b>Fitimi i vitit para tatimit</b>		<b>3,560,162</b>
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		<b>(535,524)</b>
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	23	(535,524)
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>3,024,638</b>
<b>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>-</b>
<b>Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>3,024,638</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

# AUDITI I JASHTËM

Albsig Jetë sh.a

(Vlerat janë në Lek)

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL  
13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019**

Pozicioni financiar më 13 shtator 2019	Kapitali aksionar	Fitimi i mbartur	Fitimi i vitit	Totali
Emetimi i kapitalit aksionar	402,000,000	-	3,024,638	405,024,638
Transferim në fitime të mbartura	-	-	-	-
<b>Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019</b>	<b>402,000,000</b>	<b>-</b>	<b>3,024,638</b>	<b>405,024,638</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Drejtimi i Shoqërisë më \_\_\_ maj 2019 dhe janë firmosur nga:

  
Z. Ervin Spahiu  
Drejtor i Përgjithshëm

  
Z. Irfan Lami  
Drejtor i Financës

Politikat kontabël dhe Shënimit nga faqja 7 deri ne faqen 29 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.

# AUDITI I JASHTËM

Albsig Jetë sh.a

(Vlerat janë në Lek)

## PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË

13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019

Shënime	Për periudhën 13 shtator 2019 deri më 31 dhjetor 2019
<b>Flukset monetare nga aktivitetet operative</b>	
Fitimi neto para tatimit	3,560,162
Rregullime për zërat jo-monetare në fitim ose humbje:	
Zhvlerësimi dhe amortizimi	5,238
Të ardhurat nga interesi	(1,582,312)
Humbje nga kembimet valutore	
<b>Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues</b>	<b>1,983,088</b>
<b>Ndryshimet në</b>	
Llogari të arkëtueshme bruto nga sigurimi (Rritje)/Rënie në llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	(2,077,607)
Aktive të lidhura me risigurimin	(9,373,174)
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	(290,966)
Rritja në aktive të tjera	(372,270)
Rritje/(Rënie) në llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	(10,000)
Rritje/(Rënie) në detyrime të tjera	19,254,940
Rritje në rezervat e primit të pafituar	1,681,164
Rritje në rezervat teknike për dëmet	1,660,722
<b>Fluksi monetar gjeneruar nga veprimtaria operative</b>	<b>12,455,897</b>
Tatimi fitimi i paguar	-
Interesi i paguar	-
Interesi i arkëtuar	-
<b>Fluksi monetar neto i gjeneruar nga veprimtaria operative</b>	<b>12,455,897</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet investuese:</b>	
Blerje të aktiveve afatgjata material	(271,583)
Blerje të aktiveve afatgjata jo material	(125,358)
Rënie\Rritja në investime	(370,674,398)
Investime në shoqëri të lidhura	(32,000,000)
<b>Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaria investuese</b>	<b>(403,071,339)</b>
<b>Fluksi monetare nga veprimtaritë e financimit</b>	
Emelimi kapitalit aksionar	402,000,000
<b>Fluksi monetar neto i përdorur nga veprimtaritë e financimit</b>	<b>402,000,000</b>
<b>Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë bankë</b>	<b>11,384,558</b>
Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit	-
<b>Mjetet monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit</b>	<b>11,384,558</b>

11

Politikat kontabël dhe Shënimet nga faqja 7 deri në faqen 29 janë pjesë përbërëse, dhe duhet të lexohen së bashku me këto pasqyra financiare.



# AUDITI I JASHTËM

## 1. AKTIVE NË MBULIM TË PROVIZIONEVE TEKNIKE

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt	% faktike	Investime mbi limitet e lejuara
I.	Aktivët e lejuara në mbulim të provizioneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, sipas nenit 97 të Ligjit 52/14		674,400	-	-
I.1	a) Tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Banka e Shqipërisë	100%		0.0%	-
I.2	b) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë	100%		0.0%	-
I.3	c) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të emetuar nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;	10%		0.0%	-
I.4	c) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të shoqëruara nga garanci të emetuara nga qeverisja vendore e Republikës së Shqipërisë;				
I.5	d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të tregtuar në tregje të rreguluara në Republikën e Shqipërisë;	35%		0.0%	-
I.6	d) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi, të cilët nuk tregtohen në tregje të rreguluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;	5%		0.0%	-
I.7	e) Aksione të tregtuara në tregje të rreguluara në Republikën e Shqipërisë;	25%		0.0%	-
I.8	e) Aksione, të cilat nuk tregtohen në tregje të rreguluara në Republikën e Shqipërisë, nëse emetuesi i tyre është person juridik, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë;	5%		0.0%	-
I.9	f) Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara në Republikën e Shqipërisë;	40%		0.0%	-
I.10	g) Hua të pasigurara dhe hua të sigurara nga garanci hipotekore, garanci bankare ose siguruese në Republikën e Shqipërisë, me kusht që këto të fundit të mos jenë siguruar nga shoqëri sigurimi apo banka të kontrolluara nga i njëjti grup që kontrollon dhe shoqërimin;	10%		0.0%	-
I.11	gj) Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse plotësohen njëkohësisht kërkesat sipas nenit 97, germa gjë e Ligjit 52/14;	30%		0.0%	-
	<i>Qëllime shfrytëzimi</i>				
	<i>SHEMBULL (Nr.Pasurie 1234, Volum 12, Faqe 12, Zona Kadastrale 1234, Qyteti)</i>	10%		0.0%	-
I.12	h) Depozita në banka dhe/ose degë të bankave të huaja, me seli qendrore në Republikën e Shqipërisë.	100%	674,400	40.6%	-
II.	Investime të aktiveve në mbulim të provizioneve teknike, të ndryshme nga ato matematike, për të cilat është marrë miratimi paraprak i Autoritetit;				
II.1	a) Obligacione afatgjata dhe tituj borxhi afatgjatë të emetuar nga një vend anëtar ose vend anëtar i OECD-së; që janë të klasifikuar si BBB+ e më lart sipas Standard & Poor's ose vlerësimi ekuivalent nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjërisht;				
II.2	b) Obligacione afatgjata dhe tituj afatgjatë të emetuar nga një entitet joqeveritar i një vendi anëtar ose vendi anëtar të OECD-së; me kushtin që entitetet jo qeveritare emetuese të jenë Banka Ndërkombëtare e Pagesave (BIS), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Komisioni Evropian apo banka zhvillimi shumëpalëshe, nëse ato plotësojnë të gjitha kriteret e mëposhtme:	15%		0.0%	-
	i) Për këta tituj ekzistojnë tregje aktive të marrëveshjeve të riblerjes;				
	ii) Titujt nuk janë emetuar nga bankat apo institucione të tjera financiare;				
II.3	Aksione të emetuara nga një shoqëri aksionare e huaj, e cila tregton në tregje të rreguluara të kapitalit në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së;	15%		0.0%	-



# AUDITI I JASHTËM

**Albsig Jetë sh.a**
*(Vlerat janë në Lek)*

Nr.	Emërtimi	% e lejuar	Vlera në fakt	% faktike	Investime mbi limitet e lejuara
II.4	Kuota/aksione të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të cilat tregtohen në një vend anëtar ose vend anëtar të OECD-së.				
III.	Investime të tjera të lejuara sipas Rregullores nr. 19, date 28.04.2015, neni 4:		15,979,294		14,891,182
III.1	b) Kredi individuale hipotekore për apartamente banimi vetëm për punonjësit e shoqërisë së sigurimit;	1%		0.0%	-
III.2	c) Para dhe ekuivalentë të saj (të cilat përfaqësojnë mjete monetare në arkë, mjete monetare në bankë dhe depozita me afat maturimi më të vogël se 3 muaj), në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë, me seli në Republikën e Shqipërisë;	3%	11,384,558	685.5%	11,334,736
III.3	c) Të arkëtueshmet nga risiguruesit, që nuk janë pezull më shumë se 90 ditë nga lindja e detyrimit;	25%		17.5%	-
III.4	d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike, kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më poshtë nga Standard & Poor;		290,966		
III.5	d) Pjesën e risiguruesit në provigjonet teknike, kur risiguruesit janë të klasifikuar si BBB- e më lart nga Standard & Poor;	100%		0.0%	-
III.6	e) Depozita në shoqëri ceduese dhe borxhe të zotëruara nga ato;	20%		0.0%	-
III.7	f) Shuma, që detyrohen nga policëmbajtësit dhe ndërmjetësit, e që rrjedhin nga veprimtaria e sigurimeve të drejtpërdrejta dhe risiguruese, n.q.s nga dita e detyrimit të pagesës nuk kanë kaluar më shumë se 90 ditë, por jo më shumë se 20 % e provigjontit të primit të pagfatur;	20%	2,077,607	125.1%	1,745,463
III.8	g) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara, përveç atyre të parashikuara në shkronjën "gj", pika 1, të nenit 97, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".	5%	271,583	16.4%	188,547
III.9	h) Interesa dhe qera të maturuara dhe të ardhura të tjera të maturuara.	5%	1,582,310	95.3%	1,499,274
III.10	i) Investimet në depozitat e garancisë së Kartelit jeshil pranë BSHS	100%		0.0%	-
III.11	j) Shpenzimet e marrjes në sigurim të shtyra	15%	372,270	22.4%	123,162
IV	<b>TOTALI I INVESTIMEVE (I+II+III)</b>		<b>16,653,694</b>		<b>14,891,182</b>
V	<b>TOTALI I INVESTIMEVE TE LEJUARA (Totali i "Vlera në fakt" zbritur "Investime mbi limitet e lejuara")</b>		<b>1,762,513</b>		
VI	<b>C. Provigjone teknike, të ndryshme nga ato matematike, bruto (VI.1 deri VI.5)</b>		<b>1,660,722</b>		
VI.1	Provigjone të primit të pagfatur		1,660,722		
VI.2	Provigjone të dëmeve				
VI.3	Provigjone për bonuse dhe rabate				
VI.4	Provigjone barazimi dhe katastrofe				
VI.5	Provigjone të tjera teknike				
VII	<b>Tepicë (+) / Mungesë(-) (V-VI)</b>		<b>101,791</b>		
VIII	<b>Mbullimi në % (V/VI)</b>		<b>106.13%</b>		

# AUDITI I JASHTËM

Albsig Jetë sh.a

(Vlerat janë në Lek)

## 2. RAPORT MBI MJAFTUESHMËRINË E KAPITALIT

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
I	Kapitali bazë, Neni 76 i Ligjit 52/14 (I.a+I.b+I.c-II)	404,964,518
I.a	Kapitali aksionar i shoqërisë së sigurimit, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme të anëtuara;	402,000,000
I.b	Rezervat e kapitalit, të cilat nuk i korrespondojnë detyrimeve që rrjedhin nga kontratat e sigurimit;	
I.c	Fitim i pashpërndarë, i mbartur pas zbritjes së dividendëve të pagueshëm	3,024,638
II	Elementat që nuk përfshihen në llogaritjen e kapitalit bazë: (II.a+II.b+II.c+II.ç)	120,120
II.a	Aksionet e veta të riblera	
II.b	Investimet në aktive të patrupëzuara	120,120
II.c	Humbjet e mbartura dhe humbja e vilit ushtrimor	
II.ç	Diferenca midis provigjoneve të dëmeve të skontuara dhe të paskontuara.	
III	Kapitali shtesë, neni 77 i Ligjit 52/14 (III.a+III.b+III.c+III.ç)	0
III.a	Kapitali aksionar i cili përbëhet nga aksionet me përparësi të akumuluar	
III.b	Instrumente të borxhit të varur	
III.c	Rezerva kapitali që lidhen me aksionet me përparësi të akumuluar	
III.ç	Elemente të tjera	
IV	Elementet e zbritshme në llogaritjen e kapitalit, neni 79 i Ligjit 52/14 (IV.a+IV.b+IV.c+V)	41,363,174
IV.a	Pjesëmarrje dhe instrumente të borxhit të varur në një tjetër shoqëri sigurimi, risigurimi, grupi kontrollues sigurimi, banka dhe/ose degë të bankave të huaja, shoqëri komisionere, shoqëri administruese dhe institucione të tjera financiare, në të cilat shoqëria e sigurimit zotëron pjesëmarrje influencuese mbi 10 për qind	32,000,000
IV.b	Investime të tjera në personat e parashikuar në shkronjën "a", të kësaj pike, që janë përfshirë në llogaritjen e kapitalit të personave përkatës	
IV.c	Pjesëmarrjet dhe titujt e borxhit të varur, si dhe investime të tjera në një shoqëri tjetër sigurimi ose ente financiare, të tjera nga ato të parashikuara në shkronjën "a", të kësaj pike, të cilat kalojnë masën 10 për qind të kapitalit të shoqërisë së sigurimit, e llogaritur përpara zbritjes së elementeve të përmendura në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike	
V	Aktivet jolëkuide (V.a deri V.g)	9,363,174
V.a	Aksionet e palëtuara në tregje të rregulluara	
V.b	Huatë/llogaritë e arkëtueshme me palë të lidhura	
V.c	Huatë nga brokerat dhe agjentët;	
V.ç	Primet e arkëtueshme ose dëborë nga risigurimi, që kanë tejkaluar afatin 90- ditor;	
V.d	Debitorë të tjerë ose llogari të tjera të arkëtueshme, të cilat nuk rrjedhin drejtpërsëdrejti nga veprimtaria e sigurimit;	9,373,174
V.dh	Inventari	10,000
V.e	Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	
V.ë	Shpenzimet e parapaguara	
V.f	Aktivet e tjera, të cilat nuk janë të lira nga çdo përgjegjësi apo detyrim i parashikuar	
V.g	Aktivet e tjera, të cilat nuk janë lehtësisht të kthyeshme në para në momentin kur është e nevojshme përmbushja e detyrimeve financiare kur u vjen afati	
V.h	Elemente të tjera të zbritshme sipas nenit 4 të kësaj rregullore (V.h-1 deri V.h-3);	0
V.h-1	<i>Emri i mirë i shoqërisë</i>	
V.h-2	<i>Toka, ndërtesa dhe të drejta në pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë nëse nuk plotësohen nëkohësisht kërkesat sipas nenit 4, pika 1, germa c) të rregullores</i>	
V.h-3	<i>Aktive alatgjata materiale për të cilat shoqëria nuk zotëron dokumentacionin mbi pronësinë;</i>	

# AUDITI I JASHTËM

**Albsig Jetë sh.a**
*(Vlerat janë në Lek)*

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
V.h-4	<i>Aktive afatgjata materiale që vijnë nga shpenzime për përmirësimin e ambienteve me qira</i>	
V.h-5	<i>Aktive afatgjata materiale në formën e materialeve publitare</i>	
V.h-6	<i>Likuiditete në Banka, në rast se shoqëria ka një linjë kredie të hapur në Hogari mjedhëse (overdraft) apo të ngjashme, në vlerën maksimale të kredisë së hapur në Hogari mjedhëse (overdraft) apo të ngjashme;</i>	
V.h-7	<i>Të ardhura të ligjshme nga paditë e regresit nga Fondi / Kompensimit apo të tjera në rast se shoqëria nuk ofron dokumentacion justifikues të mjaftueshëm për të garantuar ardhëtimin e shumës</i>	
V.h-8	<i>Të gjitha aktivet e lëna si kolateral, të lënë peng apo që nuk janë të lira nga çdo barrë tjetër në të gjithë vlerën e tyre</i>	
V.h-9	<i>Fondi i Garancisë për Kartomin Jashtë</i>	
V.h-10	<i>Çdo në tjetër në kundërshtim me kërkesat ligjore, rregullatore dhe vendime të Bordit të Autoritetit</i>	
VI	<b>KAPITALI (Aftësisë Paguese)</b>	<b>343,521,344</b>
VII	Kufiri minimal i aftësisë paguese, sipas pikës 3 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	0
VIII	Fondi i garancisë, sipas nenit 81 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
IX	Niveli i kërkuar i aftësisë paguese, sipas pikës 2 të nenit 80 të Ligjit Nr. 52/2014	370,000,000
X	Mbi (+) / nën (-) nivelin e kërkuar të Aftësisë paguese (VI-IX)	(-6,478,656)
XI	Mjaftueshmëria e kapitalit	I pamjaftueshëm

# ZHVILLIMET KRYESORE GJATE VITIT 2019.

## Trajnim për produktet e Albsig-Jetë për stafin e Albsig.sh.a.

Me marrjen e licencës nga AMF dhe fillimit të veprimtarisë të “Albsig-Jetë”, u zhvillua sesioni i parë i trajnimeve për produktet e Sigurimit të Jetës për periudhën Shtator-Dhjetor 2019. Në trajnim morën pjesë stafi i Drejtorisë Qëndrore dhe Degët me gjithë rrjetin e shitjes të Albsig. Duke qenë se produktet e sigurimit të jetës zënë një përqindje të vogël në tregun e sigurimeve dhe janë më pak të njohura, është parë e nevojshme njohja e këtyre produkteve, kontratave, kushteve të përgjithshme dhe ato shtesë, përjashtimet, procesit të marrjes në sigurim e etj., me qëllim hyrjen në treg dhe shitjen e këtyre produkteve nëpërmjet produkteve të jo-jetes ose të kombinuara.





## Trajnim mbi produktet e Albsig-Jetë në bizneset e Tiranës.

Stafi I Albsig-Jetë, ka ndërmarrë një nismë të rëndësishme për informimin e bizneseve për produktet dhe tarifat e tyre . Sesionin e trajnimeve për rëndësinë e produkteve të jetës ka filluar me bizneset e përqendruara me shumë në qytetet Tiranë e Durrës duke u zgjatur më pas dhe në qytetet e tjera sipas rrjetit të shitjeve të Albsig. Qëllimi I trajnimeve të Albsig jete është njohja e produkteve tarifave dhe mundësinë e qasjes së klienteve duke plotësuar portofolin e produkteve që ata tashmë disponojnë jo vetëm nga Albsig Sh.a.

## Albsig -Jetë Sh.a takim me studentet e universitetit të Tiranës.

"Edukimi financiarë i brezit të ri dhe njohja e rëndësive të sigurimit të jetës ".Ky ka qenë qëllimi i takimit të sotëm me studentët e Universitetit të Tiranës,takim ky i realizuar nga stafi I drejtuesve të Albsig-Jete. Fokusi I këtij takimi ishte mbështetje , sensibilizimi dhe njohja e brezit të ri me rëndësinë e sigurimit të jetës, për një të ardhme me të sigurte.



# RISKU I LIKUIDITETIT

Norma e likuiditetit është raporti midis aktiveve likuide të shoqërisë dhe detyrimeve të maturuara për pagesë si dhe detyrimeve që maturohen së shpejti. Shoqëria e sigurimit konsiderohet likuide në qoftë se rezultati i llogaritjes së normës së likuiditetit, referuar në nenin 6 të rregullores “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”, është më i lartë ose i barabartë me 1 (një). Për qëllim të monitorimit të likuiditetit shoqëria bën monitorimin e fluksit të parasë në mënyrë periodike duke u bazuar në llogaritjet me bazë ditore të normës së likuiditetit.

Gjatë vitit 2019 Shoqëria Albsig Jete sh.a referuar në nenin 6 të rregullores “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit”, ka rezultuar me vlerë të normës së likuiditetit gjithmonë më të lartë se 1 (një).

## STRUKTURA ORGANIZATIVE


Kapacitetet njerëzore janë tepër të rëndësishme për suksesin e shoqërisë. Albsig - Jetë synon të mbledhë një bërthamë profesionistësh me etikë dhe integritet. Një staf i tillë do ketë një ndikim të fortë në krijimin e besueshmërisë të konsumatorëve dhe partnerëve tek shoqëria. Produktet e sigurimit të jetës, sidomos ato që lidhen me kursimet afatgjata dhe investimet kërkojnë një përjasje të ndryshme nga shitja dhe trajtimi i produkteve tradicionale të sigurimit. Theksi në këto produkte është në njohjen e instrumentave dhe strategjive të investimit në tregjet financiare. Si e tillë edhe shitja e këtyre produkteve kërkon një informim të ndryshëm dhe shpesh të personalizuar të konsumatorëve.

Duke patur parasysh se burimet njerëzore në tregun shqiptar të sigurimeve, me njohuri të kënaqshme të sigurimeve të jetës, shoqëria do ndjekë një strategji të kujdesshme të zhvillimit të këtyre burimeve:

- a)** Stafi i shoqërisë do përzgjidhet me kujdes, për të arritur përzierjen maksimale të stafit të ri, të mirë arsimuar dhe premtues, me stafin me përvojë dhe që njeh mirë tregun.
- b)** Albsig Jetë do tëndjekë politika agresive dhe intensive trajnimi të stafit, duke vënë në dispozicion fonde, si dhe duke përdorur hapësirat dhe mundësitë e ofruara nga shoqëritë partnere risiguruese.



# ORGANIGRAMA



# OBJEKTIVAT E SHOQËRISË ALBSIG-JETË SH.A. PËR VITIN 2020

## Objektivat strategjikë

Bazuar në eksperiencën si dhe në njohjen nga afër dhe shtrirjen në tregun vendas të shoqërisë bazë Albsig jo jetë dhe aksionerit kryesor të saj si dhe eksperiencën në tregun rajonal, shoqëria Albsig-Jetë ka përcaktuar objektivat e saj kryesore:

- Hartimi i produkteve cilësore të sigurimit, në përshtatje me kërkesat e konsumatorëve dhe me prime reale të përballueshme prej tyre.
- Krijimi i një rrjeti efektiv të marrjes në sigurim në qytetet kryesore të Shqipërisë në funksion të arritjes së pjesës së tregut të sigurimeve të jetës prej 5% në vitin e parë të biznesit dhe rritja e saj graduale rreth 24 % në vitin e shtatë.
- Vendosja e një sistemi cilësor të shërbimit në të gjitha drejtimet, me fokus të vecantë në shërbimin e trajtimit dhe pagesës së dëmeve ndaj klienteve ose të tretëve.
- Arritja e rezultatit pozitiv të shoqërisë që në vitin e dytë të aktivitetit të saj dhe rritja e tendencës së fitimit.
- Efektiviteti i burimeve njerëzore. Nxitja e politikave bashkëkohore të rekrutimit, motivimit, trainimit dhe programeve sociale.
- Cilësia e manaxhimit dhe rritja e rolit të profesionistëve në aspektet e drejtpërdrejta të sigurimit (marrje në sigurim, dëme), në manaxhimin e të gjitha risqeve të tjera (vlerësime aktuariale, financiare, të risigurimeve, etj).
- Rritja e rolit të auditit të brendshëm dhe në përgjithësi forcimi i qeverisjes së drejtë të shoqërisë që do të shërbejnë për të parandaluar dhe kapur çdo problem në fazën e tij me të hershme.
- Rritja e imazhit të shoqërisë dhe shndërrimi i emrit në një sinonim të shërbimit më të mirë në Shqipëri.



natyrisht  
përJetë



**Sigurimi i Jetës për Hua**



**Sigurimi i Jetës dhe  
Aksidenteve**



**Sigurimi Jetë Shëndet  
Aksidente**



## **Sigurimi i Jetës për Hua**



## **Sigurimi i Jetës dhe Aksidenteve**







## Sigurimi i Jetë Shëndet Aksidente




### KONTAKT

 Rr. "Barrikadave", Albsig HQ, Kati  
8, Tiranë - Shqipëri

 +355 (0) 254770

 [info@albsig-jete.al](mailto:info@albsig-jete.al)

 [www.albsig-jete.al](http://www.albsig-jete.al)